



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 41
Prishtinë, më 23.02. 2010 në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N- 10

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Drita Kadriu, Arsim Rexhepi, Heset Cakolli, Enis Kervan dhe Dragan Dimiq

Munguan: Donika Kadaj -Bujupi, Memli Krasniqi dhe Mark Krasniqi.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë Lule Ymeri

Në mbledhje prezantuan: përfaqësuesi i OSBE - së, i NDI - së, përfaqësuesi nga Presidenca dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit si dhe praktikantë të caktuar për Komisionin.

Mbledhjen e udhëhoqi: Drita Kadriu zv. kryesuese e parë e Komisionit.

Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve së komisionit, të mbajtura më 26 janar 2010, dhe 18.02.2010
3. Debati i Komisionit lidhur me vizitën ne Institucionet e kulturës
4. Të ndryshme

Kryesuesja , konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes.

1. Miratimi i rendit të ditës

1. Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datës 26.01.2010 dhe 18.02.2010.

Kryesuesja konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të datës 26.01.2010 dhe 18.02.2010 miratohen pa vërejtje.

3. Debati i Komisionit lidhur me vizitën ne Institucionet e kulturës

Kryesuesja i njoftoi anëtarët e Komisionit me vizitën e mbajtur më datë 22.02.2010 me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Valton Beqirin dhe drejtoreshën e Teatrit Kombëtar të Kosovës, Burbuqe Berisha.

Anëtarët e Komisionit Drita Kadriu, nënkryetare dhe Hestet Cakolli, gjatë vizitës në këto Institucione, u njoftuan lidhur me implementimin e Ligjit për Teatrin, si dhe aspektet e e organizimit dhe funksionimit të Institucioneve të kulturës në veçanti në Teatrin Kombëtar të Kosovës.

Kryesuesja tha se ministri Beqiri dha një pasyrë të gjendjes aktuale në Institucionet kulturore, me ç'rast sqaroi se ligji aktual për Teatrin nuk është duke u implementuar, ndërsa është në procedurë e sipër plotësimi dhe ndryshimi i Projektligjit për Teatrin. Ministri i njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me procesin e amendamentimit të këtij ligji, si dhe për çështjen e operës, problemet në sport, trashëgiminë kulturore, si dhe shumë çështje të tjera me të cilat ballafaqohen Institucionet kulturore.

Anëtarët e Komisionit u njoftuan edhe për statusin e rëndë material të artistëve dhe punëtorëve në Institucionet kulturore,.

Ministri i kulturës para anëtarëve të këtij Komisioni, ka paraqitur një listë, lidhur me strukturën organizative dhe numrin e punëtorëve të rinj që duhet pranuar nëpër Institucionet kulturore të Divizionit të Arteve Skenike, Muzikore dhe Pamore, sipas ligjeve të miratuara.

Drita Kadriu kërkoi sqarim lidhur me formën e organizimit të Teatrove të Qyteteve dhe funksionimin e tyre.

Ministri me këtë rast tha se në kuadër të plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për teatrin është paraparë formimi i Këshillit artistik dhe profesional i cili do të ketë mbikqyrjen e Teatrove të qyteteve.

Drejtoresha e Teatrit Kombëtar të Kosovës, Burbuqe Berisha, gjatë takimit me anëtarët e Komisionit, tha se ligji aktual për Teatrin, i cili është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, nuk është duke u zbatuar. Ajo paraqiti problemet me të cilat ballafaqohet ky institucion, anëtarët e Komisionit po ashtu shprehën shqetësimin e tyre lidhur me pagat e aktorëve. Nënkryetarja e komisionit Drita Kadriu, njëherazi kërkoi nga përfaqësues të Teatrit Kombëtar që të tregojnë gatishmëri për bashkëpunim me MKRSK-në, në përpunimin e Projektligjit për Teatrin. Drita Kadriu, theksoi se ndryshimin dhe plotësimin e këtij Ligji do të rregullohen këto çështje dhe do të gjejë zbatueshmëri në vend.

Hestet Cakolli tha se vizitat në kuadër të zbatimit të ligjeve në fuqi janë të mirëseardhura për Komisionin pasi që jemi në fazën e plotësimit dhe amendamentimit të Ligjit për Teatrin.

Ai shpjegoi se gjatë takimit me drejtoreshën e Teatrit Kombëtar u njoftuan se është në përpunim e sipër rregullorja e brendshme e punës së Teatrit dhe se bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës është në nivel.

Anëtarët e Komisionit përkrahën këtë vizitë pune dhe u pajtuan që në të ardhmen të realizohen këso lloj vizitash edhe në institucionet tjera.

4. Të ndryshme

Arsim Rexhepi tha se Komisioni në të ardhmen duhet të merret edhe me problematikën e sportit kosovar si dhe me çështjen e politikave kadrovike në Universitetin e Prishtinës.

Heset Cakolli tha se çështja lidhur me këtë çështje duhet përgatitur dhe prezentuar argumentet me qëllim të adresimit të problematikës së Universitetit të Prishtinës.

Enis Kervan propozoi që Komisioni të vizitoi komunën e Prizrenit me qëllim të njohjes së përafërt me institucionet arsimore në këtë komunë.

Komisioni u pajtua që në javën e dytë të muajit mars të bëjë një vizitë pune në komunën e Prizrenit.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 11: 30

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit,

Drita Kadriu